

Gentrit Smakaj
Skënderaj

PËRPJEKJET E ISMAIL QEMALIT PËR NDRYSHIME POLITIKE PAS KONGRESIT TË PARË XHONTURK

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Kongresi i Parë xhonturk u mbajt në Paris më 4-9 shkurt 1902. Ky kongres përbënte një pikë kthese kritike në marrëdhëniet e shqiptarëve me Perandorinë Osmane. Refuzimi i vazhdueshëm i kërkesave të shqiptarëve për autonomi gjatë sundimit të Sulltan Abdyl Hamitit II bëri që ata t'i drejtoheshin lëvizjes xhonturke. Në kongresin xhonturk u parashtruan dy pikëpamje të rëndësishme. Pikëpamja e parë u hodh nga Ismail Qemali. Sipas tij, revolucioni nuk mund të bëhej vetëm me propagandë dhe botime, ndaj duhej siguruar që në veprimtaritë revolucionare të merrnin pjesë edhe forcat ushtarake. Ndërsa pikëpamja tjetër ishte se reformat duhej të bëheshin në vend duke kërkuar ndërhyrjen e shteteve evropiane. Në përputhje me vendimin e Kongresit të vitit 1902, grupi i “decentralizimit”, ku bënte pjesë edhe Ismail Qemali, u përpoqën t'i përdornin ushtarët osmanë për të arritur konstitucionalizmin. Marshall Rexhep Pashë Mati, komandanti i forcave osmane në Tripoli, filloi operacionin në përputhje me planin e përcaktuar më parë. Ndërsa dërgoi disa nga ushtarët nën komandën e tij në Selanik, ai kërkoi mbështetje edhe nga aleatët e tij, shqiptarët. Gjatë kësaj faze I. Qemali u takua me figura të rëndësishme britanike, greke dhe me Khedivin egjiptian dhe kërkoi mbështetjen e tyre në këtë proces. Britanikët ishin në dijeni të planit sekret dhe u premtuan revolucionarëve se do të fillonin një operacion detar për të mbuluar kalimin e Rexhep Pashës.

Fjalët çelës: *Xhonturqit, Komiteti i Bashkimit dhe Përparimit, shqiptarët, Ismail Qemali, përpjekjet për grusht shteti*

Hyrje

Grupi i parë i opozitës së organizuar kundër Sulltan Abdyl Hamitit II u formua në maj ose qershor të vitit 1889.¹ Katër studentë të Kolegjit Mjekësor Ushtarak themeluan *İttihad-i Osmani Cemiyeti* (Shoqëria Osmane për Bashkim), e cila synonte ta rivendoste Kushtetutën e Mit'hat Pashës së vitit 1876.² Kjo shoqëri u riemërua Komiteti i Bashkimit dhe Përparimit në 1895.³ Në atë vit, disa anëtarë të shoqërisë përsheptuan tranzicionin në Evropë. Shoqëria vazhdoi jetën e saj si parti politike për një kohë pas revolucionit të vitit 1908.⁴

Intelektualët shqiptarë morën pjesë aktive në organizata të ndryshme të formuara nga Turqit e Rinj. Arsyet e mbështetjes së lëvizjes xhonturke nga intelektualët shqiptarë marrin kuptim në kuadrin e pikëpamjeve politike të intelektualëve shqiptarë për të ardhmen e Shqipërisë në këtë periudhë.⁵ Ideja se shqiptarët do të fitonin të drejtat që do ta çonin Shqipërinë drejt pavarësisë, nëse do të bëhej revolucioni kundër Sulltanit, ishte efektive në bashkimin e tyre në shoqëri.⁶ Prandaj shqiptarët fillimisht dolën në anën e princit Sabahattin dhe miqve të tij, që mbronin idenë e decentralizimit të

¹ Tarık Zafer Tunaya, *Türkiye’de Siyasi Partiler (1859-1952)* (İstanbul: Doğan Kardeş Basımevi, 1952), 104. François Georgeon, *Sultan Abdülhamid*, Çevirmen: Ali Berktaş (İstanbul: Homer yayınları, 2006), 303.

² Orhan Koloğlu, *Abdülhamit Gerçeği* (İstanbul: Pozitif yayınevi, 2021), 484-487.

³ Për këtë shih: Ahmet Bedevi Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler* (İstanbul: Kaynak Yayınları, 2000); Sina Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki* (Ankara: İmge kitabevi, 2014); Mehmet Şükrü Hanioglu, *Bir Siyasal Örgüt Olarak Osmanlı İttihat ve Terakki Cemiyeti ve Jön Türklük (1889-1902)* (İstanbul: İletişim Yayınları, 1985).

⁴ Feroz Ahmad, *İttihat ve Terakki 1908-1914*, çeviren: Nuran Yavuz (İstanbul: Kaynak Yayınları, 2016).

⁵ Banu İşlet Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti* (İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2007), 68.

⁶ Süleyman Kocabaş, *Kendi İtiraflarıyla Jön Türkler Nerede Yanıldı! Hayaller... Komplolar... Kayıplar 1890-1918* (İstanbul: Vatan Yayınları, 1991), 79-80. Dhjetë vjet më vonë, Ismail Qemali do të thoshte për xhonturqit: “Ata janë armiq të më të mëdhenj të Turqisë”. “Arnavutluk Ahvalı”, Sabah, 24 Mayıs 1912.

Perandorisë Osmane.⁷ Këto personalitete ishin Ibrahim Temo, Dervish Hima, Ismail Qemali, Hamdi Ohri, Nexhip Draga, Shahin Kolonja, Mithat Frashëri, Hoxha Kadri Prishtina, Jashar Erebara, Syreja Vlora etj. Shqiptarët, të cilët morën pjesë edhe në kongreset xhonturke, morën anën e princit Sabahattin.⁸ Në këtë mënyrë shpresohet që Shqipëria të fitonte një status autonom duke zbatuar programin e “decentralizimit”. Me pak fjalë kjo është arsyeja pse shqiptarë si Ismail Qemal Vlora u rreshtuan në anën e grupit decentralist të princit Sabahattin.

Ismail Qemal Vlora dhe Turqit e Rinj

Ismail Qemal Vlora u arratis nga Stambolli me një anije me flamur britanik më 1 maj 1900.⁹ Ai deklaroi se i kishte humbur të gjitha shpresat për shpëtimin e Perandorisë Osmane dhe se do t'i përqendronte përpjekjet për Shqipërinë së bashku me patriotët e tjerë shqiptarë. Ismail Qemali, pas largimit nga Stambolli, arriti në Greqi ku u takua me kryetarin e parlamentit grek dhe mbretin George I. Ministri gjerman në Athinë shkruante se Ismail Qemali “kërkonte synimet autonomiste të Shqipërisë”.¹⁰ “Arratisja” e tij nga Stambolli më 1900 nuk kaloi pa zhurmë diplomatike. Konsulli austriak në Vlorë, më 4 maj 1900, kur Ismail beu u largua nga Stambolli, lajmëroi ministrin e Jashtëm të vendit të tij se shqiptarët që vizitonin Stambollin “kanë gjetur te Ismail Qemali mbrojtësin e tyre të fortë”, se ai “asnjëherë nuk ka qenë udhëhequr nga interesat materiale dhe me gjithë postet e larta nuk ka pasuri”.¹¹

Ismail Qemali tani ishte i përkushtuar për pavarësinë e trojeve shqiptare. Sulltani po përpiqej të parandalonte propagandën e tij për pavarësi nëpërmjet njerëzve të tij. Për këtë arsye, emri i Ismail Qemalit përmendej tashmë në dokumentet zyrtare të Portës së Lartë

⁷ Kocabaş, *Kendi İtirafılarıyla Jön Türkler*, 79-80.

⁸ Gentrit Smakaj, “Birinci Jön Türk Kongresi ve Arnavutlar (Paris 4-9 Şubat 1902)”, *Cedrus XI* (2023) 445-459.

⁹ Hilë Lushaku, *Qeveria e Përkohshme e Vlorës (4 Dhjetor 1912-22 Janar 1914 Jetëshkrimet e Ministrave)* (Tiranë Urtësia Bektashiane, 2013), 19.

¹⁰ Bardhosh Gaçe, *Ata që shpallën Pavarësinë Kombëtare* (Tiranë: Botimet Toena, 2012), 16.

¹¹ Lushaku, *Qeveria e Përkohshme e Vlorës*, 19.

si një ngatërrestar që ndoqi rrugën e kryengritësit shqiptar - Skënderbeut.¹² Sipas burimeve zyrtare Ismail Qemali në këtë kohë dërgonte letra dhe gazeta në Shqipëri për qëllime propagandistike. “...Është raportuar se ai po ndiqte qëllime të liga duke dërguar gazeta dhe letra të dëmshme në Shqipëri...”¹³ Para arratisjes, Sulltani u përpoq ta bindte Ismail Qemalin të qëndronte në Stamboll nëpërmjet Ridvan Pashës. Kjo arratisje u prit me interes në shtypin e huaj dhe më së shumti i shqetësoi gjermanët. Raportet gjermane tërheqin vëmendjen për punën e Ismail Qemalit së bashku me Mithat Pashën dhe njëanshmërinë e tij probritanike. Në gazeta u raportua se arratisja ishte po aq e rëndësishme sa arratisja e Mahmud Pashës dhe se shkaktoi një bujë të madhe në *Yıldız*. Pasi shkoi nga Athina në Romë dhe u takua me disa diplomatë, Ismail Beu udhëtoi për në Londër në vitin 1901, ku pati një takim të veçantë me Lord Rosebery.¹⁴

Ismail Qemali shkoi në Egjipt në vitin 1901, pas ftesës së komitetit shqiptar atje, për të ringjallur lëvizjen xhonturke në Egjipt dhe i ofroi principatën e Shqipërisë vëllait të Khedivit egjiptian.¹⁵ Pas takimeve të Ismail Qemalit me komitetin shqiptar, të përbërë nga tre ose pesë myslimanë dhe të krishterë në Egjipt, përpjekja e tij për të fituar mbështetjen e Khedive për krijimin e një principate shqiptare nuk pati sukses dhe ai u zhvendos përsëri në Evropë.¹⁶ Megjithatë, Ismail Qemali bëri shumë për të realizuar këtë qëllim.¹⁷

Vizita e Ismail Qemalit në Kajro nuk i shpëtoi vlerësimeve të konsullit francez, i cili i shkroi eprorit të vet për Ismail beun, se: “konsiderohet si njeri shumë i mençur, patriot dhe i denjë për respekt”. Duke “gjurmuar” Ismail beun, konsulli austriak në Bruksel, Xhovenhyler, njoftoi ministrin e Jashtëm se Ismail Qemali është “tepër i zgjuar dhe i rrahur me vaj dhe me uthull”. Më pas, më 1902, Kwiatowski, njoftoi ministrin e Jashtëm austro-hungarez se: “Ismail

¹²Türkiye Cumhuriyeti Cumhurbaşkanlığı Devlet Arşivi Başkanlığı Osmanlı Arşivi (më tej: BOA). *Dâhiliye Nezareti Mektubî Kalemi Belgeleri (DH. MKT)*, 1001/43.

¹³BOA, *Dâhiliye Nezareti Mektubî Kalemi Belgeleri (DH. MKT)*, 505/60.

¹⁴İhsan Burak Birecikli, “Avlonyalı İsmail Kemal Bey’in Siyasi Faaliyetleri (1870-1908)” *Akademik Bakış*, 3,5, 2009, 104.

¹⁵*Po aty*, 105-106.

¹⁶*Po aty*, 106.

¹⁷Celal Bayar, *Ben de Yazdım*, Cilt:III (İstanbul: Baha matbaası, 1966), 211-212.

Qemali është i vetmi shqiptar i shquar që jeton jashtë shtetit dhe që mban lidhje me vendin e vet”.¹⁸

Me shumë ide të xhonturqve Ismail Qemali pajtohej, por kurrsesi nuk mund të pajtohej me centralizimin e pushtetit turk.¹⁹ Turqit e Rinj në Evropën Perëndimore nuk e pritën mirë arratisjen e tij, sikurse që komenti i Isak Sukutit, më 28 maj 1900, ku theksoi se: “...arratisja e Ismail Qemalit nuk sjell ndonjë përfundim të mirë”, por ky e ka korrigjuar qëndrimin e tij në shtatorin e atij viti, pasqyruar në një letër që i dërgoi dr. Ibrahim Temos, ku i shkroi se “*Ismail Qemali punuaka vetëm për Shqipërinë*”.²⁰ Në të vërtetë Ishak Sukuti shprehet se ata donin ta vendosnin në krye të xhonturqve Ismail Qemal Vlorën, të cilin ai e përshkruan si “një njeri jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe politikan serioz” për t’i dhënë fund presidencës së Ahmet Rizës. Mirëpo, ai shprehet gjithashtu se kjo nismë u braktis sepse Ismail Qemalit i interesonte vetëm autonomia shqiptare. Megjithatë, gazetatat britanike e përshkruajnë Ismail Qemalin si udhëheqësin xhonturk dhe shkruajnë se I. Qemali ishte më i mërzhitur nga vdekja e mbretëreshës britanike sesa qytetarët e saj.²¹

Administratorët osmanë mendonin se shoqëria në Maqedoni ishte në kontakt të vazhdueshëm me xhonturqit në mërgim dhe se Ismail Beu luajti një rol të madh në përhapjen e shoqërisë në Maqedoni.²² Si rezultat, Ismail Qemali u dënua me vdekje në mungesë për tradhti për shkak të “aktiviteteve të tij djallëzore” jashtë vendit. Të gjitha të drejtat civile, gradat dhe dekoratat e Ismail Qemalit iu pakësuan dhe iu konfiskua e gjithë pasuria.²³ Në këtë mënyrë, ndërmjet 1900 dhe 1908, Ismail Qemali është njëri prej udhëheqësve të opozitës xhonturke në mërgim.²⁴

¹⁸ Lushaku, *Qeveria e Përkohshme e Vlorës*, 24.

¹⁹ Skënder Luarasi, *Ismail Qemali* (Prishtinë: Rilindja, 1971), 55.

²⁰ Lushaku, *Qeveria e Përkohshme e Vlorës*, 19.

²¹ Birecikli, “Avlonyalı İsmail Kemal Bey’in Siyasi Faaliyetleri”, 103.

²² Gül Tokay, *Makedonya Sorunu* (İstanbul: Afa yayınları, 1995), 153.

²³ BOA, *Yıldız Parakende Evrakı Adliye ve Mezâhib Nezâreti Maruzâtı (Y.PRK.AZN)*, 22/3.

²⁴ Nathalie Clayer, “Të rimendosh nacionalizmat ballkanike: Rasti i figurës së Ismail bej Qemalit dhe i nacionalizmit shqiptar”, *Përpjekja*, Viti XX, Nr. 30-31, Tiranë: Pranverë-Vjeshtë, 2013, 10.

Ibrahim Temo dhe fisnikët e tjerë shqiptarë që vepronin në qendër të lëvizjes xhonturke, përveç synimit të përgjithshëm për rrëzimin e Sulltan Abdyl Hamitit II dhe shpalljes së Kushtetutës, synonin të arrinin një unitet të tillë që populli shqiptar të fitonte identitetin e tij kombëtar.²⁵ Elita politike shqiptare, si: Ismail Qemali, Ibrahim Temo, Dervish Hima e të tjerë, mendonin se këto dy aspekte, identiteti kombëtar shqiptar dhe lufta për lirinë e kombeve në përputhje me konstitucionalizmin, mund të qëndronin krahas krahas në të njëjtin program.²⁶ Është e rëndësishme të theksohet se për një periudhë kur joturqit, të lidhur me elementët myslimanë, ishin të pavendosur mes nacionalizmit të tyre dhe idealit të osmanizmit. Në fakt, personalitete si Ibrahim Temo dhe Dervish Hima punonin për Komitetin Bashkim dhe Përparim nga njëra anë dhe nga ana tjetër, u jepnin ndihmë financiare organizatave që punonin për pavarësinë e Shqipërisë. Është e mundur të thuhet vëzhgime të ngjashme dhe për Ismail Qemal Beun. Megjithatë, këto personalitete gradualisht ndoqën një kurs drejt nacionalizmit të tyre në këtë proces.²⁷

Megjithatë, udhëheqësit e xhonturqve nuk mendonin të njëjtën mënyrë, veçanërisht krahu i Ahmet Riza Beut, i cili ishte kundër decentralizimit të Perandorisë Osmane dhe përkrahte idenë e

²⁵ Kristaq Prifti, *Doktor Ibrahim Temo: Jeta dhe Vepra 1865-1945* (Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 1996), 111.

²⁶ *Po aty*, 167.

²⁷ M.Şükrü Hanioglu, "Osmanlıcılık", *Tanzimattan Cumhuriyet'e Türkiye Ansiklopedisi*, C:5 (İstanbul: İletişim Yayınları, 1985), 1391. Supozimi i kundërshtimit të qenësishëm midis ndërgjegjes kombëtare dhe besnikërisë perandorake mund të vihet në pikëpyetje duke vendosur "realitete paralele" dhe duke pyetur se si funksiononin këto realitete paralele brenda individëve. Vlonjatët vepruan mes realiteteve të tilla paralele të një perandorie multi-etnike. Ata ishin gjithmonë të ndërgjegjshëm për origjinën e tyre dhe karriera e tyre burokratike i bënte gjithnjë e më shumë besnikë ndaj shtetit osman dhe Sulltanit. Nga ana tjetër, kjo ishte koha kur filloi të lindte një ndërgjegje kombëtare. Ismail Qemali vuri në dukje në kujtimet e tij se ndihej krenar që gjatë sundimit osman, familja e tij i shërbeu Perandorisë me besnikëri dhe shtoi se ata ruajtën njëkohësisht patriotizmin e tyre shqiptar. Ata ruajtën edhe identitetin, edhe besnikërinë: atë "perandorake" dhe atë "kombëtare". Zyrarët shqiptarë e konsideronin veten si patriotë të dy *patrias*. Abdulhamit Kirmizi, "Imperial subjects with dual loyalties: The Vlora family between empire and nation", *Ismail Qemal Vlora dhe Elita Politike Shqiptare në Procesin e Shtetndërtimit*, Përgatiti: Ledia Dushku (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 2021), 48-49.

centralizimit. Në fakt, këto dallime mendimesh midis shqiptarëve dhe krerëve xhonturq u bënë më të dukshme gjatë dhe pas Kongresit në Paris. Princi Sabahaddin ishte kundër ideve të Ahmet Riza Beut. Ibrahim Temo mbështeti pikëpamjet e Princit Sabahedin Beu për menaxhimin e decentralizuar të Perandorisë Osmane, pasi ai i konsideronte ato pozitive për të ardhmen e shtetit.²⁸ Princi Sabahedin i tha Dervish Himës se qeveria osmane do t'i njihte patjetër të drejtat e shqiptarëve në të ardhmen dhe se xhonturqit ishin kundër shqiptarëve dhe vetë Sabahedin Beut.²⁹ Gjithashtu Ismail Qemali kundërshtoi programin centralist të xhonturqve.³⁰

Në letrat që Dervish Hima i dërgonte Ibrahim Temos, nga Gjeneva dhe Parisi, shprehte domosdoshmërinë e dërgimit të njerëzve në Shqipëri dhe dëshirën për të hyrë në Shqipëri për t'i shërbyer më mirë vendit. Prandaj Dervish Hima krijoi një lidhje me Xhemil Beun nga Vlora.³¹ Dervish Hima do të përpiquej vazhdimisht të hynte në Shqipëri deri në vitin 1908, por këtë do ta arrinte menjëherë pas fitores së Revolucionit Xhonturk. Me kthimin në vendlindje, në gusht 1908, ai do të arrestohej nga autoritetet osmane.³²

Qëndrimi i Ismail Qemalit në Kongresin e Parë xhonturk

Në dhjetor 1899, xhonturqve iu hap rruga e zhvillimeve të reja. Damat Mahmut Pasha dhe djemtë e tij, Sabahedin Beu dhe Lutfullah Beu, ikën në Evropë nëpërmjet Marsejës.³³ Kjo arratisje u dha forcë dhe moral disidentëve. Mahmut Pasha dhe djemtë e tij, të cilët shkuan në Kajro në vitin 1900, me një artikull të quajtur "Për qytetarët tanë të përgjithshëm osmanë" bënë një ftesë për të organizuar një kongres të përgjithshëm në Paris dhe për të siguruar unitetin ndërmjet xhonturqve. Kjo ftesë u prit pozitivisht nga disa xhonturq

²⁸ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 19, Dosja. (më tej: D.) 32/4. Fleta 129-132. (18 Nisan 1896).

²⁹ AQSH. F. 19. D. 32/3 (1906).

³⁰ AQSH. F. 19. D. 32/2, Fleta 202-203.

³¹ AQSH. F. 19. D. 32/2. 1903.

³² BOA, *Dâhiliye Nezareti Şifre Kalemi Belgeleri (DH. ŞFR)*, 404/64; BOA, *Dâhiliye Nezareti Şifre Kalemi Belgeleri (DH. ŞFR)*, 405/03.

³³ BOA, *Yıldız Esas Evrakı (Y.E.E)*, 56/4; BOA, *Hariciye Nezâreti Sefaret Belgeleri (HR.SFR.1)*, 123/50; BOA, *Hariciye Nezareti Siyasî Kısmı Belgeleri (HR.SYS)*, 1806/63/87/2/7; BOA, *Yıldız Esas Evrakı (Y.E.E)*, 56/2.

dhe u shfaqën kërkesa që kongresi të mblidhej sa më shpejt.³⁴ Kongresi i Parë xhonturk do të mblidhet në një atmosferë mosmarrëveshjeje të thella, e cila ekziston jo vetëm midis xhonturqve dhe përfaqësuesve të kombeve perandorake, por edhe midis drejtuesve të lëvizjes xhonturke.³⁵

Me gjithë ndarjet dhe konfliktet midis xhonturqve, Kongresi i Parë xhonturk u mblodh në Paris ndërmjet 4-9 shkurt 1902.³⁶ Megjithëse fotografia e delegatëve të Kongresit tregon se mund të ishin rreth 35 delegatë, ka burime që pretendojnë se numri i delegatëve ishte 47³⁷ ose 60-70³⁸. Duke u mbështetur edhe në veprat e studiuesit dhe historianit turk Sina Akshin, mund të thuhet se numri i delegatëve ishte rreth 40.³⁹ Këta delegatë përfaqësonin turqit, arabët, grekët, kurdët, çerkezët, armenët, hebrenjtë dhe shqiptarët.

Ndër përfaqësuesit shqiptarë që morën pjesë në Kongresin e Parë xhonturk ishin: Ismail Qemali, Dervish Hima, Hoxha Kadri dhe Jashar Erebara.⁴⁰ Ismail Qemali pranoi të merrte pjesë, por me disa kushte. Ai kërkoi që, së pari, të përfaqësoheshin të gjithë elementët etnikë në Turqi, në mënyrë që, në Kongres të formuloheshin dëshirat e gjithë popujve të Perandorisë. Sipas mendimit të Ismail Qemalit, kishte rëndësi që ata që qenë kundër Sulltan Abdyl Hamitit II të vepronin për të krijuar një qeveri kombëtare, që do të ishte e paanshme dhe e

³⁴ Fatih Mehmet Sancaktar, *Osmanlı'dan Cumhuriyet'e Anayasa, Seçim ve Meclis Tecrübesi (1876 –*

1923) (İstanbul: Ötüken Neşriyat, 2021), 58-59.

³⁵ M.Şükrü Hanioglu, *Preperation for a Revolution: The Young Turks, 1902-1908* (Oxford and New York: Oxford University Press, 2001); Ernest E. Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*, Türkçesi: Muhsin Önal Mengüşoğlu (İstanbul: Pınar Yayınları, 2011).

³⁶ Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*, 190; Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*, 80.

³⁷ Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*, 97. Dyzet e shtatë delegatë që përfaqësonin turqit, arabët, grekët, kurdët, çerkezët, armenët, hebrenjtë dhe shqiptarët morën pjesë në Kongres.

³⁸ Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*.

³⁹ Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*, 80.

⁴⁰ Prifti, *Doktor Ibrahim Temo*, 174.

dobishme për gjithë popujt e Perandorisë.⁴¹ Për këtë arsye, që nga ajo ditë ai ishte në konflikt me grupin e Ahmet Riza beut. Sipas Ismail Qemalit, ishte një grup xhonturk që nuk kishte parime mjaftueshëm liberale. Mirëpo, Ahmet Rizaj akuzon Ismail Qemalin se po ndjek ambicie të fshehta dhe se po përdor xhonturqit për interesat e tij.⁴²

Sipas kujtimeve të Ismail Qemalit lidhur me këtë çështje, Princi Lutfullah e ftoi personalisht të merrte pjesë në Kongresin Xhonturk. Edhe Ismail Qemali deklaroi se donte të merrte pjesë në një kongres të tillë, por kishte kushte: “Kushti i parë është që e gjithë Perandoria Osmane të përfaqësohet në mënyrë që të merren parasysh dëshirat e të gjithë popujve të Perandorisë. Kushti tjetër është që Fuqitë e Mëdha që kanë nënshkruar marrëveshjet e Berlinit dhe Parisit të informohen, sepse në sytë e popullit osman ata kanë marrë përsipër, me dinjitetin e tyre, të zbatojnë reformat në të mirë të Perandorisë”. Ismail Qemali shpjegoi pse ai i parashtrroi këto kushte si më poshtë: Ai mendonte se kongresi mund të kishte kuptim nëse kërkohej ndihmë nga Evropa, përndryshe do të mbetej i kufizuar si një vend ku secili mund të prezantonte idetë e tij.⁴³ Prandaj, sipas Ismail Qemalit, duhet kërkuar ndihma e Fuqive të Mëdha që Kongresi i Turqve të Rinj të ketë sukses. Propozimet e paraqitura nga I. Qemali u pranuan dhe ai vajti në Kongres si përfaqësues i popullit shqiptar.⁴⁴ Duke marrë pjesë në Kongresin e Parë xhonturk I. Qemali u zgjodh në komitetin ekzekutiv së bashku me Princin Sabahedin dhe Fazil Beun dhe u bë njeriu i dytë i Shoqërisë së Decentralizimit.⁴⁵

Kongresi u hap me një fjalim të jashtëzakonshëm nga princi Sabahedin Beu. Në fjalën e hapjes së Kongresit, Princi Sabahedin ftoi qytetarët e racave dhe feve të ndryshme që të bashkëpunojnë për të shkatërruar regjimin absolutist të Sulltan Abdyl Hamitit II dhe për të

⁴¹ Luarasi, *Ismail Qemali*, 55-56; Kristaq Prifti, “Kontributi i Shqiptarëve në Lëvizjen e Turqve të Rinj (1889-1908)” (*Gjurmime Albanologjike Seria e shkencave Historike* 31-32, 2001-2002, Prishtinë: 2003), 225.

⁴² Birecikli, “Avlonyalı İsmail Kemal Bey’in Siyasi Faaliyetleri”, 107.

⁴³ *İsmail Kemal Bey Hatıratı*. Ed: S.Story, çev: A.İslamoğulları - R. Hoxha. İstanbul: Tarih Vakfı Yayınları, 2009); Rezart Mezani, *İttihat ve Terakki, Arnavutlar ve Arnavutluk*, Ege Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü (Tezë Masteri) (İzmir: 2003), 87.

⁴⁴ Luarasi, *Ismail Qemali*, 56.

⁴⁵ Kocabaş, *Kendi İtirafıyla Jön Türkler*, 79-80.

ndërmarrë një nismë themelore reformuese në Perandorinë Osmane. Për të kryer një reformë rrënjësore në Perandorinë Osmane, ishte i nevojshëm largimi i Abdyl Hamitit II nga pushteti.⁴⁶ Në Kongres u parashtruan dy teza të rëndësishme. Sipas të parës, revolucioni nuk mund të bëhej vetëm me propagandë dhe botime, ndaj duhej siguruar që në veprimtaritë revolucionare të merrnin pjesë edhe forcat ushtarake. Askush nuk e kundërshtoi këtë pikëpamje të paraqitur nga Ismail Qemali dhe në fakt pak më vonë u bë një përpjekje në këtë drejtim.⁴⁷ Sipas tezës së dytë reformat duhet të bëhen në vend duke kërkuar ndërhyrjen e qeverive të huaja.⁴⁸

Ismail Qemali dhe përpjekjet për grusht shteti më 1902-1903

Në Kongresin e parë të Turqve të Rinj të mbajtur në Paris, Ismail Qemali paraqiti pikëpamjen e tij, që deri në atë kohë nuk ishte përfshirë në programin e Komitetit të Bashkimit dhe Përparimit. Ajo shfaqet për herë të parë në programin e miratuar nga Kongresi i Parisit i vitit 1902.⁴⁹ Në Kongres, Ismail Qemali e portretizoi veten si përfaqësues i një force të rëndësishme ushtarake. Duke argumentuar se asgjë nuk mund të arrihej me botime, ai rekomandoi që të bëhen përpjekje për pajisjen e mëtejshme të kësaj force që ai përfaqësonte dhe për të bërë një grusht shteti në Stamboll.⁵⁰ Por Ismail Qemali tha se meqenëse nuk do të ishte e arsyeshme që kjo çështje të diskutohej në një seancë publike, ai mund t'ia jepte informacionin e nevojshëm për këtë çështje një komisioni që do të zgjidhej nga një këshill i përgjithshëm, nëse ky këshill e shihte të arsyeshme.⁵¹

Ismail Qemali e shpreh këtë në kujtimet e tij si më poshtë: “Çështja e parë e diskutuar është përcaktimi i të gjitha gabimeve të Sulltan Abdyl Hamitit II dhe masat që duhen marrë me mjete legjitime

⁴⁶ Cavit Orhan Tutengil, *Prens Sabahaddin* (İstanbul: İstanbul Matbaası, 1954), 25-26.

⁴⁷ Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*, 81.

⁴⁸ Cemal Kutay, *Prens Sabahaddin Bey, Sultan II. Abdülhamit, İttihad ve Terakki* (İstanbul: Tarih Yayınları Müessesesi, 1964), 145.

⁴⁹ Mezani, *İttihat ve Terakki, Arnavutlar ve Arnavutluk*, 88. Shih Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*, 190.

⁵⁰ Birecikli, “Avlonyalı İsmail Kemal Bey’in Siyasi Faaliyetleri”, 108.

⁵¹ Kutay, *Prens Sabahaddin Bey, Sultan II. Abdülhamit, İttihad ve Terakki*, 145-146

dhe me miratimin e shteteve liberale... Grupi xhonturk, i udhëhequr nga Ahmet Rizaj, këmbënguli në përgatitjen e një administrate qendrore të përqendruar në Stamboll për të mirën e turqve. Unë isha duke mbrojtur një propozim për veprim që do të ishte efektiv dhe alarmues dhe do të tërhiqte vëmendjen e Evropës. Për ta arritur këtë, mjaftonte të zinte një vend strategjik me një forcë ushtarake, si Selaniku apo Bosfori, që është çelësi i ngushticës së Dardaneleve”.⁵²

Personi më i përshtatshëm për këtë veprim dukej se ishte Marshalli Rexhep Pashë Mati, komandanti i ushtrisë në Tripoli.⁵³ Grupi i Princit Sabahedin kontaktoi në Maltë me Shevqet Beun, ndihmësin e shqiptarit Rexhep Pasha, për të realizuar idenë e Ismail Qemalit për një revolucion duke përfshirë ushtarët.⁵⁴

Ernest Ramsaur e përshkruan këtë situatë si më poshtë: “Princi Sabahedin negocioi një marrëveshje me Ismail Qemalin, një person i rëndësishëm që ishte i dëshpëruar për shkak të dështimit për të arritur një konsensus në kongresin e fundit, për të përshpejtuar një revolucion të mundshëm në Perandorinë Osmane. Kjo marrëveshje ndoshta është maturuar në fund të vitit 1902. Megjithatë, vdekja e Damat Mahmut Pashës në janar 1903 përkoi me fazën përgatitore të revolucionit”.⁵⁵

Menjëherë pas Kongresit u krijua një komitet i quajtur “Shoqëria Liridashëse Osmane”, ku kryetar u zgjodh Ismail Qemali. Statusi i komisionit në fjalë, i përbërë nga 20 nene, u botua në gazeta. Pasi

⁵² Kemal Bey Hatıratı, 126.

⁵³ Rexhep Pasha ka lindur në fshatin Muzhat të Matit. Xhaxhai i tij, furrtar në Edrene, e merr me vete në atë qytet, ku vazhdon mësimet në një shkollë të mesme ushtarake, dhe, pasi mbaron këto, kryen në Stamboll edhe mësimet e Akademisë dhe të Shtatmadhorisë ushtarake. Rexhep Pasha, për shkak të ideve të tij liberale e patriotike mbahej larg Stambollit dhe larg Shqipërisë nga sulltan Hamiti, i cili më parë e kishte emëruar guvernator dhe komandant të Armatës së 5-të në Bagdad. Ndonëse me kompetenca të gjëra, mbahej atje paksa si gjysmë i internuar. Më vonë, po me ato kompetenca, emërohet në Tripolin afrikan guvernator dhe komandant i përgjithshëm i ushtrisë. Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime Politike në Shqipëri (1897-1942)*, Përgatitja për botim dhe ilustrimi fotografik prof. as. dr. Marenglen Verli, (Tiranë: Shtëpia Botuese “Vllamasi”, 2012), 34-35. Për informacione të detajuara në lidhje me Rexhep Pashë Matin shih: Abdulnasır Yiner, Müşir Recep Paşa, Askeri ve Siyasi Hayatı (1842-1908) (İstanbul: İdeal, 2017), 257-262.

⁵⁴ Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, 80.

⁵⁵ Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*, 108.

dëgjoi propozimet e Ismail Beut, komiteti cakton Princin Sabahedin dhe Fazli Beun së bashku me të për të shqyrtuar dhe kryer revolucionin.⁵⁶

Plani u hartua si më poshtë: Marshall Rexhep Pasha, komandanti i forcave osmane në Tripoli, filloi operacionin siç ishte rënë dakord. Ndërsa dërgoi disa nga ushtarët nën komandën e tij në Selanik, ai thirri në ndihmë edhe aleatët e tij, shqiptarët. Kapja e Bosforit, që ishte në një pozicion shumë strategjik në Gjirin e Saros, do t'i jepte atij mundësinë për t'i kontrolluar Dardanelet. Sipas Ismail Qemalit, të gjitha këto zhvillime do të tërhiqnin vëmendjen e Evropës dhe do të bënin presion ndaj Sulltanit për t'iu afruar marrëveshjes.⁵⁷

Pasi mori miratimin e Rexhep Pashës për këtë çështje, Ismail Qemali shkoi tek ambasadori britanik në Paris dhe hapi çështjen. Puna duhet t'i jetë dukur e përshtatshme, sepse ambasadori i dha Ismail Qemalit një letër që të mund të takohej me sekretarin e Jashtëm, Lord Lansdowne. Edhe pse ministri ishte jashtë Londrës për shkak të vizitës së perandorit gjerman, Ismail Qemali u takua me nënsekretarin e Punëve të Jashtme, Lord Sandersonin. Në një takim të dytë, Sandersoni lexoi një letër nga Lord Lansdowne, që premntonte të mbështeste iniciativën në mënyrë të fshehtë. Kur anijet të mbërrinin në Çanakala, në Beshikë do të ishte edhe marina britanike. U pa e përshtatshme të ndërpritej linja telegrafike midis Odesës dhe Konstancës në mënyrë që bota e jashtme të mos informohej menjëherë për incidentin.⁵⁸ Ismail Qemali madje përgatiti një deklaratë për t'iu drejtuar ushtarëve gjatë grusht shtetit. Deklarata ishte planifikuar në këtë mënyrë: *“Nëse nuk e hiqni Sulltan Abdyl Hamitin, i cili është ulur sot në kodrën Yıldız, do të ngrihen kryqe në kupolat e xhamive të Shën Sofisë dhe të Sulltan Ahmetit në kodrën tjetër”*.⁵⁹

Kishte edhe një aspekt financiar të çështjes.⁶⁰ Për këtë qëllim, 10.000 monedha ari u morën hua nga Sir Ernest Cassel, pronari i

⁵⁶ Birecikli, “Avlonyalı İsmail Kemal Bey’in Siyasi Faaliyetleri”, 108.

⁵⁷ Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*, 108.

⁵⁸ Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*, 84-85.

⁵⁹ Ali Haydar Midhat, *Osmanlı’dan Cumhuriyet’e Hatıralarım 1872-1946* (İstanbul: Bengi Kitap Yayın, 2008), 176.

⁶⁰ Në këtë drejtim mendohej se anijet që do të sillnin ushtarët mund të merreshin nga Athina dhe Sabahedin Beu siguroi burimet e nevojshme financiare. Kuran, 166

Bankës Kombëtare Turke. Ismail Qemali shkoi në Egjipt për të takuar Lordin Cromer pa i informuar miqtë e tij. Sipas asaj që tha, Cromer e nisi fjalën e tij duke u shprehur se nuk e pranonte një gjë të tillë si problemi i Turqisë dhe kjo situatë e shqetësoi shumë Ismail Qemalin. Megjithatë, Ismail Qemali jo vetëm e bindi për ekzistencën e një problemi të tillë, por edhe e bëri të pranonte se Anglia ishte një nga bashkëbiseduesit më të rëndësishëm të këtij problemi për krijimin e një Turqie të fortë dhe aleate.⁶¹ Ismail Qemali u takua edhe me Khediv Abbas Hilmiun dhe nëpërmjet tij u siguruan 4.000 monedha të tjera ari nga Lord Kerri Bank. Natyrisht, ishte një strategji e gabuar për ta ngritur çështjen me një lojtar të dyfishtë si Abbas Hilmiu. Megjithatë, Ismail Qemali besonte se përveç të bërit biznes dhe të sigurosh jetesën me para të bollshme, ishte e nevojshme që revolucioni të kryhej me metoda "aristokratike".⁶² Në lidhje me ngjarjen informacione të rëndësishme na jep Ali Hajdar Mithat, i cili përfshiu tentativën për grusht shtet në kujtimet e tij. Ali Hajdar Mithat deklaroi se *bankierët britanikë dhanë para për iniciativën, dhe se Khedivi egjiptian gjithashtu ofroi ndihmë financiare. Por, Khedivi egjiptian gjithashtu informoi Sulltan Abdyl Hamitin për këtë ngjarje. Ismail Qemali donte të siguronte pavarësinë e Shqipërisë duke dërguar trupa në të. Por, kjo ofertë u refuzua nga Rexhep Pasha, i cili nuk ishte i gatshëm të tradhtonte.*⁶³ Qëllimi kryesor i Ismail Qemalit që në fillim ishte pavarësia e Shqipërisë dhe se ai e tërhoqi në krah princin Sabahedin, duke fshehur qëllimin e tij.⁶⁴ Ismail Qemali përfitoi nga natyra e tij shqiptare dhe i bëri Rexhep Pashës ofertën e mëposhtme: Është më mirë të dërgojmë ushtarë në Shqipëri dhe të përpiqemi të sigurojmë pavarësinë e Shqipërisë. Në këtë mënyrë kërcënohet edhe Sulltan Abdyl Hamiti II.⁶⁵

Ismail Qemali kishte dërguar mikun e tij Xhafer Brejdanin në Bengazi për t'u takuar me Rexhep Pashën. Pas një kohe të shkurtër,

İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler, 196-197; Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, 81.

⁶¹ Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*, 109.

⁶² Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*, 84-85.

⁶³ Midhat, *Osmanlı'dan Cumhuriyet'e Hatıralarım*, 176-178.

⁶⁴ *Po aty*; Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar: II.Meşrutiyet Döneminde Arnavut Ulusçuluğu ve Arnavutluk Sorunu* (İstanbul: Büke Kitapları, 2004), 94.

⁶⁵ Ali Haydar Midhat, *Osmanlı'dan Cumhuriyet'e Hatıralarım*, 178.

Ismail Qemali u nis për në Londër. Kur arriti në Paris, pa se Sabahedini dhe Lutfullahu ishin mjaft të mërzhitur për shkak të vdekjes së papritur të babait të tyre, Damat Mahmut Pashës. Megjithatë, me gjithë dhimbjen e tij, Princi Sabahedin nuk u përmbajt të shoqëronte Ismail Qemalin në udhëtimin e tij për në Londër në përgatitjen e infrastrukturës financiare të revolucionit të planifikuar. Para se të nisej për udhëtim, Princi Sabahedin ia përcolli Ismail Qemalit lajmin se tri anije greke në Athinë po prisnin udhëzimet e tij për të lundruar në Bengazi. Pas kësaj, Qemal Beu ndryshoi drejtimin e rrugës dhe shkoi në Athinë. Megjithatë, ndryshe nga sa u tha, ai u habit kur pa se këtu nuk ishin bërë përgatitje paraprake.⁶⁶ Sipas Ismail Qemalit, plani i madh kishte pësuar një goditje shumë të rëndë, sepse ishte e nevojshme të fillonte nga e para për të zgjidhur problemin e transferimit të ushtarëve. Dhe sigurisht, këto dhe punime të ngjashme do të kërkonin shumë kohë.⁶⁷ Ismail Qemali këmbënguli që iniciativa të mbështetej nga Khedivi i Egjiptit dhe mbreti i Greqisë dhe, kur nuk iu dha mbështetja, ai hoqi dorë nga revolucioni i tij. Megjithatë, braktisja e Ismail Qemalit bëri që Rexhep Pasha të tërhiqej nga nisma dhe nga kjo përpjekje nuk u arrit asnjë rezultat.⁶⁸

Historia e përshkruar nga Ismail Qemali në kujtimet e tij mund të konsiderohet e vërtetë, por kur të shohim rrjedhën e përgjithshme të ngjarjeve, do të konkludojmë se pak është zhvilluar në favor të tij. Studiuesi E. Ramsaur shprehet se *Ular dhe Insabato ishin absolutisht të gabuar duke menduar se përpjekja për grusht shteti ndodhi në 1908. Për më tepër, mendimi i tyre se Ismail Qemali punonte nën urdhrat e Anglisë, Austrisë, Italisë dhe Greqisë në të njëjtën kohë ishte ndoshta një mendim i gabuar*.⁶⁹ Gjithashtu, Ahmet Bedevi Kuran këmbëngul se Ismail Qemali, me gjithë paratë që i ishin besuar, aplikoi në mënyrë hipokrite për shumë njerëz, përfshirë Khedivin egjiptian dhe Mbretin grek, pa u konsultuar as me miqtë e tij. Me fjalë të tjera, sipas tij,

⁶⁶ Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*, 109-110.

⁶⁷ *Po aty*, 110.

⁶⁸ Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, 81; Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*, 196-197.

⁶⁹ Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*, 110-111.

qëndrimi i pavendosur i Ismail Qemalit ishte arsyeja pse gjërat nuk shkuan ashtu siç ishin planifikuar.⁷⁰

Ishte e qartë se idetë e Ismail Qemalit për të mbështetur interesat britanike bazoheshin në një themel të fortë. Sërish nuk kishte nevojë të konfirmohej vërtetësia e asaj që tha për marrëdhëniet e tij me njerëz të ndryshëm nga Anglia. Anglia ishte tashmë e vetëdijshme se mosvendosja e pengesave në rrugën e përpjekjes për grusht shteti në 1903 nuk do ta bënte atë të humbiste asgjë. Për më tepër, suksesi i një nisme të tillë do të forconte ndikimin e Britanisë në Perandorinë Osmane në çdo kuptim. Një detaj tjetër i rëndësishëm që i bëri të vërteta deklaratat e Ismail Qemalit në lidhje me premtimin e tij për mbështetje fshihej në fjalët e mëposhtme: *“Ne jemi të rrethuar nga një hezitim i natyrshëm që rrjedh nga fakti se revolucioni ynë ende nuk ka ndodhur”*.⁷¹

Duke lënë mënjanë këto dhe spekulime të ngjashme, pati një konsensus midis Ular, Insabato dhe Kuran se britanikët ishin në dijeni të planit sekret dhe u premtuan revolucionarëve se do të fillonin një operacion detar për të mbuluar kalimin e Rexhep Pashës. Eshhtë e panevojshme të thuhet se burimet britanike preferuan të heshtin për këtë temë. Në fakt, duke u parë si mbështetje e një përpjekjeje të dështuar grusht shteti për të rrëzuar sundimtarin e një vendi tjetër ishte një situatë që asnjë komb nuk mund ta pranonte.⁷²

Ismail Qemali synonte ta arrinte revolucionin me mjete aristokratike, pra me mbështetjen e sundimtarëve si Mbreti grek dhe Khedivi egjiptian. Dështimi për të gjetur mbështetje nga figura të larta të përfshira në tentativën e revolucionit ishte zhgënjyese për udhëheqësit shqiptarë. Ismail Qemali e të tjerë e panë më të përshtatshme të hiqnin dorë nga revolucioni përballë kësaj situatë.⁷³

Përfundim

Mendohej se Kongresi xhonturk, i mbajtur në Paris në shkurt 1902, do të hapte një horizont të ri në drejtim të integritit. Në fund të takimit, ku morën pjesë kryesisht mbështetës të Sabahattinit, u pa se ndarja ishte më efektive se bashkimi. Si rrjedhojë, Kongresi nuk

⁷⁰ Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*, 199-206.

⁷¹ Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*, 111.

⁷² *Po aty*.

⁷³ Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*, 205.

mundi të siguronte unitetin e lëvizjes së xhonturqve. Pas kongresit, xhonturqit u ndanë në dy grupe: “pro ndërhyrjes dhe kundër ndërhyrjes”. Nga njëra anë ishte Ahmed Rizaj, përfaqësuesi i pikëpamjes kundër ndërhyrjes së huaj dhe Komiteti “pozitivist-centralist” i Bashkimit dhe Përparimit nën udhëheqjen e tij. Nga ana tjetër, Princi Sabahedin, përfaqësues i pikëpamjes në favor të ndërhyrjes së huaj dhe nën drejtimin e tij u krijua Shoqata e Ndërmarrjeve dhe Decentralizimit “liberalisto-federaliste”.

Ismail Qemali dhe intelektualët e tjerë shqiptarë synuan të bënin një revolucion kundër Sulltan Abdyl Hamitit II duke krijuar një aleancë me xhonturqit. Ky revolucion do t'i jepte Shqipërisë autonomi dhe më pas do t'i hapte rrugën pavarësisë. Për këtë arsye, liderë shqiptarë si Ismail Qemali u rreshtuan në anën e grupit decentralist të Princ Sabahedit.

Për t'i arritur këto synime, si Ismail Qemali ashtu edhe intelektualët e tjerë shqiptarë, pas Kongresit xhonturk, bënë përpjekje për organizimin e një grusht shteti kundër regjimit absolutist të Sulltan Abdyl Hamitit II. Ismail Qemali nuk mbeti vetëm me fjalë. Ai u dakordua me mareshalin e ushtrisë osmane në Tripoli, Rexhep Pashë Matin, për të zbarkuar në ndonjë vend strategjik të Turqisë, që do të shërbente si fillimi i përmbysjes së regjimit të vjetër osman. Mirëpo ngjarjet ndoqën njëra tjetrën me atë shpejtësi sa që prej këtij plani nuk u realizua asgjë.

BIBLIOGRAFIA

1. Burimet Arkivore

A. Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

AQSH. F. 19. D. 32/4.

AQSH. F. 19. D. 32/3.

AQSH. F. 19. D. 32/2.

AQSH. F. 19. D. 32/2.

B. Türkiye Cumhuriyeti Cumhurbaşkanlığı Devlet Arşivi Başkanlığı Osmanlı Arşivi (BOA)

BOA, *Dâhiliye Nezareti Mektubî Kalemi Belgeleri (DH. MKT)*, 1001/43.

BOA, *Dâhiliye Nezareti Mektubî Kalemi Belgeleri (DH. MKT)*, 505/60.

BOA, *Yıldız Parakende Evrakı Adliye ve Mezâhib Nezâreti Maruzâtı (Y.PRK.AZN)*, 22/3.

BOA, *Hariciye Nezâreti Sefaret Belgeleri (HR.SFR.1)*, 123/50.

BOA, *Hariciye Nezareti Siyasî Kısmı Belgeleri (HR.SYS)*, 1806/63/87/2/7.

BOA, *Dâhiliye Nezareti Şifre Kalemi Belgeleri (DH. ŞFR)*, 404/64.

BOA, *Dâhiliye Nezareti Şifre Kalemi Belgeleri (DH. ŞFR)*, 405/03.

BOA, *Yıldız Esas Evrakı (Y.E.E)*, 56/2.

BOA, *Yıldız Esas Evrakı (Y.E.E)*, 56/4.

2. Gazetat

Sabah, 24 Mayıs 1912. "Arnavutluk Ahvali".

3. Literatura Historiografike

Ahmad, Feroz. *İttihat ve Terakki 1908-1914*. çeviren: NuranYavuz. İstanbul: Kaynak Yayınları, 2016.

Akşin, Sina. *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*. Ankara: İmge Kitabevi, 2014.

Ali Haydar Midhat. *Osmanlı'dan Cumhuriyet'e Hatıralarım 1872-1946*. İstanbul: Bengi Kitap Yayın, 2008.

Bayar, Celal. *Ben de Yazdım*. Cilt:III, İstanbul: Baha matbaası, 1966.

Birecikli, İhsan Burak. "Avlonyalı İsmail Kemal Bey'in Siyasi Faaliyetleri (1870-1908)" *Akademik Bakış*, 3,5, 2009.

Clayer, Nathalie. "Të rimendosh nacionalizmat ballkanike: Rasti i figurës së Ismail bej Qemalit dhe i nacionalizmit shqiptar", *Tiranë: Përpekja*, Viti XX, Nr. 30-31, 2013.

Çelik, Bilgin. *İttihatçılar ve Arnavutlar*. İstanbul: Büke Kitapları, 2004.

Gaçe, Bardhosh. *Ata që shpallën Pavarësinë Kombëtare*, Tiranë: Botimet Toena, 2012.

Georgeon, François. *Sultan Abdülhamid*. Çevirmen: Ali Berktaş. İstanbul: Homer Yayınları, 2006.

Hanioğlu, Mehmet Şükrü. *Bir Siyasal Örgüt Olarak Osmanlı İttihad ve Terakki Cemiyeti ve Jön Türklük (1889-1902)*. (İstanbul: İletişim Yayınları, 1985).

Hanioğlu, M.Şükrü. "Osmanlılık". *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi* (İstanbul: TDV Yayınları, 1985).

Hanioğlu, M. Şükrü. *Preperation for a Revolution: The Young Turks, 1902-1908*. Oxford and New York: Oxford University Press, 2001.

İsmail Kemal Bey Hatıratı. Ed: S.Story, çev: A.İslamoğulları - R. Hoxha. İstanbul: Tarih Vakfı Yayınları, 2009.

Kirmizi, Abdulhamit. "Imperial subjects with dual loyalties: The Vlora family between empire and nation", *Ismail Qemal Vlora dhe Elita Politike Shqiptare në Procesin e Shtetndërtimit*, Përgatiti: Ledia Dushku. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, 2021.

Kuran, Ahmet Bedevi. *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*. İstanbul: Kaynak Yayınları, 2000.

Kutay, Cemal. *Prens Sabahaddin Bey, Sultan II. Abdülhamit, İttihad ve Terakki*. İstanbul: Tarih Yayınları Müessesesi, 1964.

Kocabaş, Süleyman. *Kendi İtiraflarıyla Jön Türkler Nerede Yanıldı! Hayaller.... Komplolar.... Kayıplar 1890-1918*. İstanbul: Vatan Yayınları, 1991.

Koloğlu, Orhan. *Abdülhamit Gerçeği*. İstanbul: Pozitif Yayınevi, 2021.

Lushaku, Hilë. *Qeveria e Përkohshme e Vlorës (4 Dhjetor 1912-22 Janar 1914 Jetëshkrimet e Ministrave)*. Tiranë: Urtësia Bektashiane, 2013.

Smakaj, Gentrit, "Birinci Jön Türk Kongresi ve Arnavutlar (Paris 4-9 Şubat 1902)", *Cedrus XI* (2023) 445-459.

Luarasi, Skënder. *Ismail Qemali*. Prishtinë: Rilindja, 1971.

Mezani, Rezart. *İttihat ve Terakki, Arnavutlar ve Arnavutluk*. Ege Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü (Tezë Masteri) (İzmir: 2003).

Sancaktar, Fatih Mehmet. *Osmanlı'dan Cumhuriyet'e Anayasa, Seçim ve Meclis Tecrübesi (1876 -1923)*. İstanbul: Ötüken Neşriyat, 2021.

Sönmez, Banu İşlet. *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*. İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2007.

- Prifti, Kristaq. *Doktor Ibrahim Temo: Jeta dhe Vepra 1865-1945*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 1996.
- Prifti, Kristaq. "Kontributi i Shqiptarëve në Lëvizjen e Turqve të Rinj (1889-1908)". Prishtinë: *Gjurmime Albanologjike Seria E shkencave Historike* 31-32, 2001-2002, 2003.
- Ramsaur, Ernest E. *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*. Türkçesi: Muhsin Önal Mengüşoğlu. İstanbul: Pınar Yayınları, 2011.
- Vllamasi, Sejfi. *Ballafaqime Politike në Shqipëri (1897-1942)*, Përgatitja për botim dhe ilustrimi fotografik Prof. as. dr. Marenglen Verli. Tiranë: Shtëpia Botuese "Vllamasi", 2012.
- Yiner, Abdulnasır. *Müşir Recep Paşa, Askeri ve Siyasi Hayatı (1842-1908)*. İstanbul: İdeal, 2017.
- Tokay, Gül. *Makedonya Sorunu*. İstanbul: Afa yayınları, 1995.
- Tunaya, Tarık Zafer. *Türkiye'de Siyasi Partiler (1859-1952)*. İstanbul: Doğan Kardeş Basımevi, 1952.
- Tutengil, Cavit Orhan. *Prens Sabahaddin*. İstanbul: İstanbul Matbaası, 1954.

ISMAIL QEMAL'S EFFORTS FOR POLITICAL CHANGES AFTER THE FIRST YOUNG TURK CONGRESS

Summary

Despite divisions and conflicts among the Young Turks, the First Young Turk Congress met in Paris between February 4-9, 1902. Among the Albanian representatives who participated in the First Young Turk Congress were Ismail Qemali, Dervish Hima, Hoxha Kadri and Jashar Erebara. Ismail Qemali agreed to participate but with some conditions. He demanded that, first, all the ethnic elements in Turkey be represented, so that, in that congress, the wishes of all the peoples of the empire could be formulated. In Ismail Qemali's opinion, it was important that those who were against Sultan Abdyl Hamit II act to create a national government that would be impartial and beneficial to all the peoples of the empire.

Ismail Qemali's conditions were accepted and he went to the congress as a representative of the Albanian people. Taking part in the First Young Turk Congress, Ismail Bey was elected to the executive committee along with Prince Sabahatti and Fazil Bey and became the second man of the Decentralization Society.

Two important theses were presented at the congress. According to the first, the revolution could not be done only with propaganda and publications, so it had to be ensured that the military forces also participated in the revolutionary activities. No one opposed this view presented by Ismail Qemali. According to the second thesis, the reforms should be done in the country, requiring the intervention of foreign governments.

Immediately after the congress, a committee called "Liberal Ottoman Society" was created, where Ismail Qemali was elected chairman. The status of the commission in question, consisting of 20 articles, was published in newspapers. After hearing Ismail Bey's proposals, the committee appoints Sabahat and Fazli Bey along with him to consider and carry out the revolution. Marshal Rexhep Pashë Mati, the commander of the Ottoman forces in Tripoli, began the operation in accordance with the previously determined plan. While he sent some of the soldiers under his command to Thessaloniki, he

also asked for support from his allies, the Albanians. The capture of the Bosphorus, which is in an extremely strategic position in the Gulf of Saros, would give him the opportunity to control the Dardanelles. According to Ismail Qemali, all these developments would attract the attention of Europe and put pressure on the Sultan to come closer to the agreement. After receiving Rexhep Pasha's approval for this issue, Ismail Qemali met with important British and Greek figures and the Egyptian Khedive and asked for their support in this process. Ismail Qemali insisted that the initiative be supported by the Khedive of Egypt and the King of Greece, and when support was not given, he gave up his revolution. However, the abandonment of Ismail Qemali caused Rexhep Pasha to withdraw from the initiative and no result was achieved from this effort.

